



**Ihr schulärztlicher Dienst**  
**Shërbimi juaj i mjekut shkollor**

Gesundheitsdienst der Stadt Bern  
Schulärztlicher Dienst  
Monbijoustrasse 11  
Postfach  
3001 Bern  
[www.bern.ch/gesundheitsdienst](http://www.bern.ch/gesundheitsdienst)

## Të dashur prindër

Si prindër keni të drejtën për një shoqërim falas të mjekut shkollor të fëmijës suaj që nga koha e kopshtit për fëmijë deri në klasën e 9-të. Në shërbimin e mjekut shkollor punojnë mjekte, punëtore sociale dhe punëtorë socialë dhe asistente të mjekut shkollor. Ata i nënshtrohen obligimit të heshtjes.

Vizita e parë tek mjekja shkollore mbahet në **kopshtin e fëmijëve**. Aty kontrollohen veçanërisht aftësia e shikimit, dëgjimit, shkathtësia dhe gjuha, sepse këto janë tejet të rëndësishme për mësuarje. Ju shoqëroni fëmijën tuaj në këtë kontrollim dhe i raportoni mjekes shkollore për zhvillimin e tij. Së bashku me mjeken bisedoni, se a është gjithçka në rregull apo fëmijës suaj i duhet përkrahje speciale.

Në rast të vështirësive në lëvizje apo në të folur në moshën e kopshtit për fëmijë dhe në moshën shkollore mjekja është kompetente për udhëzim në mësim special. Ajo ju ndihmon edhe rreth asaj, se kur dhe si duhet të fillojë shkollën fëmija juaj.

Edhe në vitet vijuese në rast të problemeve të fëmijës suaj mund të merrni **këshillime në çdo kohë**. Telefononi thjesht shërbimin tuaj shkollor-mjekësor dhe caktoni një termin.

Në **klasën e katërt** pason kontrollimi i dytë nga mjeku shkollor i të gjithë fëmijëve. Këtu bëhet fjalë para së gjithash për mirëqenien në shkollë, për rritjen dhe për kontrollin e kurrizit. Nëse dëshironi mundeni edhe në këtë kontrollim të jeni prezent.

Në **klasën e tetë** mbahet kontrollimi i fundit nga mjeku shkollor. Kësaj here me të rinjtë zhvillohet një bisedë krejtësisht personale rreth çështjeve speciale në këtë fazë të jetës, si p. sh. Zgjedhja e profesionit ose sjellja shëndetësore (ngrënja, pirja e duhanit, fjetja etj.). Gjatë këtij kontrollimi prindërit nuk marrin pjesë, sepse të rinjtë e kësaj moshe mundin vetë të përgjigjen mirë. Në rast të problemeve të rënda kërkohen zgjidhje me ndihmën e prindërve.

Kështu përcjellim fëmijët nga kopshti për fëmijë deri tek largimi nga shkolla dhe gëzohemi për përparimet e tyre. Kjo përcjellje duhet të kontribuojë që fëmijët në shkollë të ndjehen mirë dhe që mundësisht të mundin të mësojnë mirë. Ne i njohim edhe mësimdhënësit e tyre dhe kërkesat e shkollës. Shfrytëzoni këto njohuri, ne ju përgjigjemi pyetjeve tuaja dhe ju këshillojmë me gjithë dëshirë .

Mjekja e Juaj shkollore

## Liebe Eltern

Als Eltern haben Sie das Recht auf eine kostenlose schulärztliche Begleitung Ihres Kindes ab Kindergarten bis in die 9.Klasse. Im schulärztlichen Dienst arbeiten Ärztinnen, Ärzte und Schularztassistentinnen. Sie alle unterstehen der Schweigepflicht.

Der erste Besuch bei der/dem Schulärztin/Schularzt findet im **Kindergarten** statt. Untersucht werden insbesondere Sehen, Hören, Geschicklichkeit und Sprache, weil diese für das Lernen besonders wichtig sind. Sie begleiten Ihr Kind zur Untersuchung und berichten der/dem Schulärztin/Schularzt über seine Entwicklung. Gemeinsam besprechen Sie mit der/dem Ärztin/Arzt, ob alles in Ordnung ist oder ob Ihr Kind spezielle Unterstützung braucht.

Bei Bewegungs- und Sprachschwierigkeiten im Kindergarten- und Schulalter ist die/der Schulärztin/Schularzt zuständig für die Abklärung und Empfehlung von Spezialunterricht. Sie/er hilft Ihnen auch, wenn es darum geht zu klären, wann und wie Ihr Kind in die Primarschule eingeschult wird.

Auch in den folgenden Jahren können Sie bei Problemen Ihres Kindes **jederzeit Beratung** erhalten. Telefonieren Sie einfach Ihrem schulärztlichen Dienst und vereinbaren Sie einen Termin.

In der **4.Klasse** folgt die zweite schulärztliche Untersuchung aller Kinder. Hier geht es vor allem um das Wohlbefinden in der Schule, um das Wachstum und um die Kontrolle des Rückens. Wenn Sie es wünschen, können Sie auch bei dieser Untersuchung dabei sein.

In der **8.Klasse** findet die letzte schulärztliche Untersuchung statt. Diesmal wird mit den Jugendlichen ein ganz persönliches Gespräch geführt über spezielle Fragen in dieser Lebensphase, wie z.B. die Berufswahl oder das Gesundheitsverhalten (Essen, Rauchen, Schlafen usw.). Die Eltern sind bei dieser Untersuchung nicht dabei, weil die Jugendlichen in diesem Alter gut selber Auskunft geben können. Bei schwerwiegenden Problemen wird mit Hilfe der Eltern nach Lösungen gesucht.

So begleiten wir die Kinder vom Kindergarten bis zum Schulaustritt und freuen uns über ihre Fortschritte. Diese Begleitung soll dazu beitragen, dass die Kinder sich in der Schule wohlfühlen und dass sie möglichst gut lernen können. Wir kennen auch ihre Lehrpersonen und die Anforderungen der Schule. Nehmen Sie diese Kenntnisse in Anspruch, wir beantworten Ihre Fragen und beraten Sie gerne.

Ihre Schulärztin/Ihr Schularzt